

Menaxhimi i Ankesave në Kompaninë e Sigurimeve "SCARDIAN" J.S.C.

Trajtimi i ankesave të klientëve në fushën e sigurimeve është një aspekt i rëndësishëm për të siguruar kënaqësinë e klientëve dhe për të mbajtur reputacionin e kompanisë.

Ju sigurojmë që ankesat në K.S.SCARDIAN do të trajtohen në mënyrë të drejtë dhe objektive, brenda afateve të parapara me qëllim të ofrimit të zgjidhjes së drejtë për ju.

Ju Inkurajojmë që të na vlerësoni mbi procesin e ankesës, për arësye se vlerësimet rreth përvojës tuaj gjatë shfrytëzimit të produkteve dhe shërbimeve tona na ndihmojnë të kuptojmë më mirë nevojat tuaja dhe të përmirësojmë shërbimet dhe produktet e ofruara për ju. Ne e vlerësojmë secilin reagim dhe konsiderojmë me seriozitet secilin koment dhe ankesë tuajën.

Në vazhdim ju informojmë për hapat dhe këshillat për të menaxhuar këtë proces:

Dërgo ankesën

Informacioni i shënuar me * është i nevojshëm.

Emri*

Mbiemri*

Numri i telefonit*

Email*

Adresa*

Shkruaj ankesën*



Pëlqimi

Termat dhe Kushtet

Me shtypjen/klikimin e butonit "Pëlqim" shprehimisht pajtohem dhe i jap pëlqimin Kompanisë së Sigurimeve "SCARDIAN" J.S.C. që në pajtim me Ligjin nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale...

Mbyll ^

Me shtypjen/klikimin e butonit "Pëlqim" shprehimisht pajtohem dhe i jap pëlqimin Kompanisë së Sigurimeve "SCARDIAN" J.S.C. që në pajtim me Ligjin nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale Personale, të përpunojë të dhënat e mija personale të lartcekura si dhe të dhënat që mund të bëhen të njohura më vonë, të shkëmbehen dhe përdoren nga K.S."SCARDIAN" J.S.C., për të procesuar aplikacionin e paraqitur dhe për të më kontaktuar me shkrim, me telefon dhe/ose nëpërmjet postës elektronike në adresën time të shënuar më lartë, me qëllim për të më dërguar oferta më përshtatshme dhe të personalizuar. Konfirmoj se të gjitha informatat e dhëna më lart janë të vërteta, të plota dhe të sakta dhe deklaroj se unë vullnetarisht i kam vënë në dispozicion Kompanisë së Sigurimeve të dhënat e mija personale.

Dërgo ankesën

Në rast se ju nuk parapëlqeni të adresoni pakënaqësinë tuaj përmes formës online, ju lutem konsideroni alternativat në vazhdim për adresimin e pakënaqësisë tuaj:

- Kontakto në numrin **+383 777 444**;
- Dërgo e-mail në ankesa@scardian.com (dërgo: emrin, mbiemrin, numrin kontaktues dhe përshkruani çështjen tuaj);
- Vizito degën më të afërt për të biseduar me punonjësit e degës apo plotëso formën e vendosur në secilën degë të K.S."SCARDIAN" J.S.C. ;
- Dërgo ankesën me postë: Kompania e Sigurimeve "SCARDIAN" J.S.C., rr.Perandori Justinian, nr.69, Prishtinë.

Për çdo ankesë të adresuar, ju do të pranoni mesazhin konfirmues në numrin kontaktues të prezantuar gjatë procesit të procesimit të ankesës. Sigurisht, për ankesën e adresuar në ndonjërin nga degët e KS "SCARDIAN" J.S.C. ju mund të kërkontë konfirmimin për ankesën e prezantuar.

Ne do të mundohemi të trajtojmë në kohe sa më të shkurtër ankesën tuaj, mirëpo jeni të informuar se kohëzgjatja e trajtimit të ankesës mund të zgjasë deri në 15 ditë, varësisht nga kompleksiteti i ankesës tuaj. Në rast se çështja e juaj do të kërkojë më shumë kohë, ne do të ju kontaktojmë për të ju informuar dhe njoftuar mbi statusin e çështjes tuaj.

Në rast se nuk do të jeni të kënaqur me zgjidhjen që i është dhënë ankesës tuaj, ju keni të drejtë të drejtoheni Autoriteteve të tjera, respektivisht BQK-së meqë rast ankesën mund ta paraqitni në njërin nga mënyrat në vijim:

- N p rmjet sistemit elektronik <https://ankesat.bqk-kos.org>
- N p rmjet adres s postare
- Duke e dor zuar personalisht n  zyr n e arkivit t  BQK
- N p rmjet fax-it por jo telefonit.